

1 Gusht 2025

Njoftim për Shtyp

Bankers Petroleum Albania Ltd. konfirmon sërish angazhimin e palëkundur ndaj platformës "Shqipëria 2030" dhe ndaj një vizioni afatgjatë, që forcon sigurinë energjetike, qëndrueshmërinë ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Shqipërisë. Ky angazhim, i cili shtrihet përtej detyrimeve rregullatore, është një premtim solemn ndaj popullit shqiptar dhe një mbështetje e qartë e ndaj lidershit të vendit, i rrënjësuar në besim, llogaridhënie dhe partneritet strategjik.

Në përputhje të plotë me institucionet dhe autoritetet kombëtare, ne konfirmojmë gadishmërinë tonë për të zbatuar, pa rezerva, Vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC) të datës 7 qershor 2024, të mbështetur nga Gjykata e Apelit e Shqipërisë (Vendimi Nr. 479, i komunikuar më 1 korrik 2025). Ekipet tona ligjore janë plotësisht të përgatitura për të punuar së bashku me institucionet përkatëse shqiptare për të siguruar ekzekutimin gjithëpërfshirës të këtij vendimi, në përputhje me standardet ndërkombëtare për të mbrojtur investimet e huaja dhe për të siguruar zbatimin me sukses të një projekti kryesor energjetik në Evropën Kontinentale, që pasqyron interesat e përbashkëta kombëtare dhe strategjike të Shqipërisë.

Ne po ndjekim me vëmendje të singertë hetimet penale, të iniciuara nga autoritetet shqiptare më 2 korrik 2025, në lidhje me disa kolegë të respektuar dhe ish-punonjës. Gjatë gjithë këtij procesi, vazhdojmë të angazhohemi haptazi me të gjitha institucionet kompetente, të udhëhequr nga një frymë transparence, respekti të ndërsjellë dhe respektimi të ligjit.

Për shembull, nën drejtimin e Kryetarit tonë të Bordit Mbikëqyrës, planifikojmë të formojmë një ekip të jashtëm për të kryer një vetë-hetim të thellë për të gjithë periudhën, duke ofruar bashkëpunim dhe ndihmë të ngushtë për autoritetet shqiptare.

Kemi shpresa të mëdha në integritetin dhe drejtësinë e sistemit gjyqësor shqiptar dhe mbetemi shpresëplotë se kjo çështje do të trajtohet me paanshmërinë dhe kujdesin që meriton. Gjithashtu, shprehim dëshirën tonë të singertë që masat aktuale të sigurisë që prekin anëtarët e ekipit tonë, të rivlerësohen në mënyrë të tillë, që të mbrojnë vazhdimësinë e operacioneve tona dhe përforcojnë besimin ndaj drejtësisë.

Të shtyrë nga angazhimi ynë ndaj inovacionit dhe përsosmërisë operacionale, Bankers Petroleum Albania është krenar të pohojë sërish qëllimin për të vijuar me investime të mëtejshme në të ardhmen energjetike të vendit. Si pjesë e këtij vizioni drejt të ardhmes, po forcojmë qeverisjen tonë dhe po përgatitemi të lançojmë një teknologji termale të përparuar të projektuar për të përmirësuar ndjeshëm rikuperimin e naftës, për të ulur kostot e prodhimit dhe për të forcuar qëndrueshmërinë afatgjatë të operacioneve tona.

Përveç kësaj, këto përmirësime pritet të luajnë një rol kyç në mbështetjen e zhvillimit më të gjerë ekonomik të Shqipërisë dhe objektivave mjedisore, duke përmirësuar efikasitetin e burimeve, duke zvogëluar gjurmën ekologjike të operacioneve dhe duke promovuar përdorimin e përgjegjshëm të aseteve energjetike.

Kjo iniciativë shënon një hap të guximshëm drejt pozicionimit të Shqipërisë si një pikë referimi rajonale për zhvillimin e përgjegjshëm dhe efikas të energjisë.

Ndërsa përparojmë në të gjitha drejtimet; ligjore, operacionale dhe teknologjike, ne vijojmë të jemi plotësisht në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, kushtet e marrëveshjes sonë të koncesionit, ICC-në dhe standardet ndërkombëtare të zbatueshme. Rruga jonë është ajo e partneritetit dhe prosperitetit të përbashkët; duke u përqendruar në mbrojtjen e investimeve afatgjata, duke nxitur inovacionin, kujdesin ndaj mjedisit dhe duke kontribuar në mënyrë vendimtare në rritjen ekonomike të Shqipërisë.

Ne e shohim rolin tonë jo vetëm si operator energjie, por si një partner i besuar në udhëtimin e zhvillimit të vendit, të përkushtuar ndaj progresit, stabilitetit dhe një të ardhmeje të qëndrueshme për të gjithë shqiptarët.